



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE

PROCESVERBAL
KOMITETI SEKTORIAL I
TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

RENDI DITËS

1. Regjistrimi dhe mirëseardhja
2. Validimi i standardeve të kualifikimeve: “*Inxhinieri Informatike Software-ike*” dhe “*Siguri Kibernetike*”
3. Diskutim i lirë. Përcaktimi i agjendës për takimin e radhës

➤ Shënime nga zhvillimi dhe diskutimet e mbledhjes së Komitetit Sektorial:

1. Regjistrimi dhe mirëseardhja

Takimi u hap nga **znj. Ejvis Gishti**, Drejtor i Përgjithshëm i AKAFPK-së, e cila falenderoi pjesëmarrësit për angazhimin. **Znj. Gishti** tha se kjo mbledhje ndryshe nga ato të mëparshmet zhvillohej në mungesë të një prej njerëzve më bashkëpunues të AKAFPK-së. Humbja e z. Mezini është një humbje e madhe, e pazëvendësueshme, tronditëse dhe që padyshim do të ndihet gjatë mungesa e optimizmit dhe dëshirës për të ecur para, që e karakterizonin aq mirë Tanin. Në nder të tij të pranishmit mbajtën një minutë heshtje. Në vijim **znj. Gishti** tha se, AKAFPK ka folur me AITA-n që të kenë një përfaqësues prej tyre në mënyrë që kompozimi të jetë i duhur dhe pritet mbyllja e procedurave nga ana e tyre për zëvendësimin e anëtarit.

2. Validimi i standardeve të kualifikimeve: “*Inxhinieri Informatike Software-ike*” dhe “*Siguri Kibernetike*”

Në vijim të agjendës **znj. Gishti** tha se, kjo mbledhje do të fokusohet në diskutimin dhe validimin e dy dokumentave, dy standardeve të kualifikimeve: “*Inxhinieri Informatike Software-ike*” dhe “*Siguri Kibernetike*”. **Znj. Gishti** sqaroi anëtarët se standardi i profesionit “*Teknikë të inxhinierisë software-ike*”, për të cilin anëtarët kishin dhënë rekomandime dhe komente mbledhjen e mëparshme, ishte diskutuar me palën austriake dhe kishin dakordësuar një draft final i cili përputhej me atë që homologët zhvillonin në Austri. Gjatë këtij takimi anëtarët do të njiheshin me standardin e profesionit të dakordësuar për të vijuar me standardin e kualifikimit.

Në vijim fjala i kaloi **znj. Aleksandra Kole** për të bërë fillimisht një rezymë të shkurtër mbi punën e bërë për hartimin e standardeve të kualifikimeve. **Znj. Kole** si fillim prezantoi dhe falënderoi z. Ilir Daka, ekspert i grupit të hartimit të standardit, i cili i ishte bashkuar mbledhjes

për çdo shpjegim apo saktësim që do të ishte i nevojshëm. Më pas, **znj. Kole** solli në vëmendje se në takimin e mëparshëm ishte diskutuar se sa duhet të ishte kohëzgjatja e profilit të sigurisë kibernetike dhe nëqoftëse duhet të ishte i hapur edhe për ata që vinin nga arsimit i përgjithshëm apo i dedikuar për arsimin profesional. Nisur nga kjo, grupi hartues kishte vendosur që profili “Siguria kibernetike” të zgjaste dy vjet dhe që mund të ndiqej nga ata që kishin mbaruar nivelin e IV të KSHK-së për TIK, si dhe nga ata që kishin mbaruar minimalisht nivelin e IV të KSHK-së për arsimin e përgjithshëm dhe që kishin të paktën një vit eksperiencë pune në fushën e TIK. Këto vendime u diskutuan dhe u miratuan edhe nga anëtarët e KS.

Në vijim, **znj. Kole** prezantoi kriteret e validimit të standardit të kualifikimit. **Znj. Gishti** shpjegon për anëtarët se, standardi i kualifikimit organizohet në njohuri, shprehje dhe kritere vlerësimi që janë bazë për ndërtimin e kurrikulës. Shumë e rëndësishme është të kuptojmë nëse këto kritere lidhen me nivelin për të cilin po flasim. Si fillim fjalën e mori **z. Daka**, i cili shpjegoi anëtarët e KS me mënyrën si grupi i punës kishte punuar gjatë hartimit, vizionin që ata kishin pasur dhe pozicionin në treg pune të specialistit që do të ndiqte këtë kualifikim. Më pas, **znj. Kole** filloi të lexonte kriteret e vlerësimit për çdo njësi të nxëni dhe **z. Daka** dha shpjegimet përkatëse për ato pjesë që anëtarët kishin paqartësi ose pyetje. Në përfundim të diskutimeve standardi i kualifikimit u miratua parimisht pa asnjë ndryshim por **z. Gentian Likaj** kërkoi që ta diskutonte edhe njëherë dokumentin me disa specialistë shumë të mirë të sigurisë kibernetike për të parë nëse mund të përmirësonin diçka. **Znj. Gishti** tha se dokumenti do ju shpërndahej anëtarëve me email dhe ata do të kishin kohë në dispozicion për ta parë edhe njëherë, ose për ta diskutuar me specialistë të tjerë të fushës.

Më pas u kalua në diskutimin e standardit të profesionit “Teknikë të Inxhinierisë software-ike”, për ato rubrika që anëtarët kishin pasur komente mbledhjen e kaluar. Standardi ishte diskutuar edhe me palën austriake në mënyrë që të kenë përputhshmëri. Komentet e anëtarëve të KS janë reflektuar sipas njësive të të nxënit. **Z. Endri Xhina** tha se parimisht standardi i profesionit ishte në rregull vetëm se emërtimi duhet të ishte “Teknik i Inxhinierisë Informative”. Anëtarët validuan standardin në formatin e dakordësuar dhe u kalua në diskutimin e standardit të kualifikimit.

Znj. Kole filloi me prezantimin e kriteve të vlerësimit sipas njësive të të nxënit. **Z. Xhina, z. Shehu, znj. Bilibashi** dhe **z. Likaj** bënë saktësime të termave të përdorur për të qenë pak më të përgjithshme, në disa nga rubrikat si: rjetet kompjuterike, programim aplikacionesh, zhvillim website dhe bazat e të dhënave. **z. Xhina** kërkoi kohë që të mund ta shikonin edhe njëherë materialin në tërësi për ndonjë shtesë apo ndryshim të mundshëm. Sekretariati teknik do të ishte përgjigjës për dërgimin e dokumentave drejt anëtarëve dhe reflektimin e komenteve të mundshme.

3. Diskutim i lirë. Përcaktimi i agjendës për takimin e radhës

Znj. Gishti propozoi që mbledhjen e ardhshme anëtarët mund të shohin edhe njëherë nevojat për aftësi në tregun e punës që kishin dalë nga studimi i nevojës së aftësive (SNA) për të vlerësuar kualifikimet ekzistuese, ato që janë krijuar të reja dhe propozime të tjera të mundshme qoftë për kualifikime afatgjata apo afatshkurtra. **Z. Xhina** propozoi që në mbledhjen e ardhshme tu vendosen në dispozicion anëtarëve të gjitha vendimet e marra dhe produktet që ka nxjerrë Komiteti gjatë kohës së funksionimit të tij.

➤ Vendime të marra nga mbledhja:

- U bë validimi i standardit të kualifikimit: “*Siguri Kibernetike*”
- U bë validimi i standardit të profesionit: “*Teknik i Inxhinierisë Informative*”
- U bë validimi i standardit të kualifikimit: “*Inxhinieri Informatike Software-ike*”